

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: INTACT SH.P.K., rr. Saraçëve pn. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	12.10.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **11.10.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **INTACT SH.P.K., rr. Saraçëve pn. me adresë në Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE**, me Numër të prokurimit: **623-21-6247-5-3-6**, Numër i brendshëm: **623-21-055-5-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **INTACT SH.P.K., rr. Saraçëve pn. me adresë në Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE**, me Numër të prokurimit: **623-21-6247-5-3-6**, Numër i brendshëm: **623-21-055-5-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **07.10.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE**, me Numër të prokurimit: **623-21-6247-5-3-6**, Numër i brendshëm: **623-21-055-5-3-6**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **INTACT SH.P.K., rr. Saraçevë pn.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE**, me Numër të prokurimit: **623-21-6247-5-3-6**, Numër i brendshëm: **623-21-055-5-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **07.10.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks.gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **11.10.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Sa i përket arsyes tuaj të parë për eliminimin tonë në lidhje me planin dinamik, ju sqarojmë se arsyetimi i juaj është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar në ndonjë dispozitë ligjore, për faktin se edhe pse nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë ne e kemi ofruar planin dinamik. Pra nëse analizohet në tërësi fleta e të dhënave të tenderit shihet qartë se askund nuk figuron kërkesa për planin dinamik.

Andaj përderisa në FDT dhe tek njoftimi për kontratë nuk e keni përcaktuar një kërkesë të tillë në FDT dhe tek njoftimi për kontratë atëherë nuk mund të eliminohet asnjë operator ekonomik me një arsyetim të tillë. Derisa një kërkesë nuk ka qenë e përcaktuar në FDT dhe nuk është parashikuar si kërkesë e kualifikueshmërisë atëherë nuk mund ligjërisht të eliminohen operatorët ekonomik për ndonjë kërkesë të papërcaktuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ju si AK me këtë veprim nuk i keni respektuar dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së pasi që në të njëjtin është e cekur qartë se *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”* Pra ju keni vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur për faktin se na keni eliminuar neve për një kërkesë e cila nuk ka qenë e parashikuar fare në FDT dhe tek njoftimi për kontratë dhe njëkohësisht na keni eliminuar neve edhe pse jemi operator ekonomik i përgjegjshëm.

Po ashtu neni 56 i LPP-së, në paragrafët e tij e parasheh qartë se si bëhet vlerësimi i ofertave, citojmë paragrafin 1:

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një

seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1.së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. Pra vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm duke u bazuar në kërkesat e kualifikueshmërisë dhe specifikimeve teknike, njëkohësisht duke marr për bazë edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që në këtë rast është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Kurse ju si autoritet kontraktues nuk e keni bërë vlerësimin e ofertave konform dispozitave të lartcekura, prandaj këtë mund ta bëni na fazën e rishqyrtimit të kësaj kërkesë për rishqyrtim.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që terminologjia Plan Dinamik ka domethënie dhe format e saja Standarde për tu plotësuar, si në vijim:



Fig. 1. Shembulli i Gantogramit të thjeshtë-(Microsoft Excel 2013)

Kërkesa jonë ka qenë:

II.5 Vendi për "[ekzekutimin e punëve]" është: NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë planin dinamik i detalizuar sipas pozicioneve të paramasës, duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga Operator Ekonomik.

Ndërsa përgjigja juaj është vetëm konfirmimi i kohëzgjatjes së implementimit prej 20 dite e cila në numër rendore është kërkesa jone: II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: 20 ditë



PLANI DINAMIK

Titulli i kontratës: RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE

Nr. i Prokurimit: 623-21-6247-5-3-6 & Nr i brendshëm: 623-21-055-5-3-6

	Shtator 2021
Afatet kohore sipas pikes II.6. DT	ka kohëzgjatje prej 20 ditë

VEREJTJE AFATI KOHOR PER: RIPARIME NË TRI OBJEKTE SHKOLLORE ,
ËSHTË 20 DITË

PRIZREN: 14.09.2021

"INTACT" SHPK



Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ndërsa sa i përket arsyes tjetër për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit nga ana juaj, në lidhje me deklaratën për specifika teknike të detyrueshme, ku sipas jush ne nuk e kemi ofruar një deklaratë të tillë. Ne ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i juaji është vetëm një pretekst i juaji për të na eliminuar neve si OE më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit, sepse askund në dosje të tenderit nuk është përcaktuar një kërkesë e tillë. Pra nëse analizohet në tërësi dosja e tenderit, në asnjë pikë të saj nuk shkruan se duhet të ofrohet një deklaratë e tillë. Mirëpo ju duke e parë se nuk mund të na eliminoni po nxjerrni arsyeime të cilat nuk qëndrojnë fare, pasi që ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe po ashtu jemi OE më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Pra ju me këtë veprim tuajin nuk e keni respektuar përsëri dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së pasi që në të njëjtin është e cekur qartë se *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”*

Referimi i juaj në nenin 39 të RRUOPP-së për eliminimin tonë ku e keni cekur se në nenin e lartcekur shkruan se: *“Mungon Deklarata për specifikat teknike-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm”*. Edhe në këtë rast shihet qartë se ju si AK jeni munduar të manipuloni edhe me dispozitat e neneve, pasi që nëse analizohet neni 39 i RRUOPP-së përkatësisht paragrafi 8, askund nuk figuron se nëse mungon deklarata për specifika teknike, duhet të refuzohet tenderi. Fillimisht ju po na eliminoni për një kërkesë e cila nuk është përcaktuar askund në dosje të tenderit dhe tek njoftimit për kontratë, ndërsa tani i referoheni edhe një dispozite të nenit e cila nuk ekziston.

Sa i përket referimit tuaj në vendimet e OSHP-së në lidhje me arsyen e lartcekur për eliminimin tonë, ju sqarojmë se ju i jeni referuar gabimisht vendimeve të lartcekura për faktin se në vendimin nr.495/21 është përmendur deklarata e specifikimeve teknike,

mirëpo e njëjta ka qenë e përcaktuar tek FDT dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa në rastin tonë një kërkesë e tillë nuk është e përcaktuar.

Ndërsa sa i përket vendimit tjetër të OSHP-së me nr.31/20, shkruan qartë se specifikimi teknik ka devijime dhe nuk është marr në konsideratë. Pra ky vendim nuk përkon fare me rastin tonë, pasi që siç e cekëm kërkesa për deklaratë për specifikime teknike nuk është kërkuar fare në FDT dhe tek njoftimit për kontratë.

Andaj veprimet tuaja për eliminimin tonë janë tendencioze dhe diskriminuese për ne si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse e keni favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na keni diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Po ashtu ju si autoritet kontraktues nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Kërkesa Standarde në Dosjen e tenderit, si shabllon i dhënë nga vetë KRPP-ja dhe jo ndonjë kriter diskriminues i hartuar nga vetë ne, është:

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - punët ☒ duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

“Deklarata për Specifikimet Teknike” e dorëzuar nga OE është një dokument që garanton se me rastin e furnizimit të këtyre mallrave, OE ofertues respektivisht kontraktuesi i mundshëm do ti ofroj mallrat sipas specifikimit teknik të AK-së.

Në ofertën e juaj të dorëzuar mungon Deklarata për Specikime Teknike të Detyrueshme dhe nuk jepni asnjë dëshmi se do ti përmbushni të gjitha specifikat teknike sipas ANKESIT 1 të Dosjes se tenderit.

Sipas RrUOPP-së, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve thotë: Mungon Deklarata për Specifikat teknike – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Neni 28 i LPP-së.

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 495/20 & 31/20, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Ne si Autoriteti Kontraktues nuk jemi thirrur vetëm ne Vendimin e OSHP-së edhe pse OSHP-ja për Deklaratën për Specifikat Teknike ka pasur shumë vendimet, shih tabelarin:

Filtro në bazë të kriteve:

DATA E PUBLIKIMIT

VLERA E KONTRATËS

AUTORITETI KONTRAKTUES

OE ANKUES

PANELI

VENDIMET E PANELIT

REKOMANDIMET E EKSPERTIT

NENET

FJALË KYÇE

☐ Afati i liferimit

☐ Ankesa e pasafshme

☐ Ankesa në kritere pas hapjes

☐ Anulim për gabime në DT

☐ Anulimi për mungesë buxheti

☐ Asnjë OE i përgjegjshëm

☐ Autorizimet

☐ Certifikata e biznesit

☐ Certifikatat ISO/EN/CE

☐ Çmim 0.00

☐ Çmim i lartë

☐ Çmimi jo-normalist i ulët

☐ Çmimi sipas poentimit

☐ CV

☐ Deklarata nën betim

☒ Deklarata për specifikat teknike

☐ Deklaratat e konzorciumit

☐ Devijim i vogël

☐ Dokument në gjuhë tjetër

☐ Dokument pa validitet

☐ Dy oferta të përgjegjshme

☐ Eliminim pa bazë

☐ Fitues me votim

☐ Formulari për dorëzim të tenderit

☐ Gabimet aritmetikore

☐ Garancioni

☐ I papërshtatshëm

☐ Interesi publik

☐ Katalogu

☐ Kërkesa për rishqyrtim pa përgjigje

☐ Kërkesa për sqarime (neni 72)

☐ Kontrata duke u ekzekutuar

☐ Kontributet për punëtorë

☐ Kriteret e përshtatura

☐ Licenca

☐ Marrëveshje e fshehtë

☐ Mbeshtetje nga banka

☐ Mosnjohimi i OE

☐ Mosofrimi i DT

☐ Mospezullimi i aktivitetit

☐ Mosrespektimi i ligjeve tjera

☐ Ndarja në Lote

☐ Ndryshim material

☐ Niveli i shkolimit

☐ Njoftimi për kontratë/DT dallojnë

☐ Noterizimi

☐ Numra pas presjes dhjetore

☐ OE vendor

☐ Originali/Kopja dallojnë

☐ OSHP pa bord

☐ Paga bruto/neto

☐ Pajisjet

☐ Palë pa interes

Rezultatet në bazë të kriteve:

: [Deklarata për specifikat teknike](#)

✖ Pastro kërkimin

Përditësimi i fundit: 2021-09-29 04:24:35

Shfaq 15 rreshta

📄

📄

📄

📄

Zgjedh kolonat

Kërko

NR. I PROTOKOLLIT	EMRI I RASTIT:	VLERA E KONTRATËS	AUTORITETI KONTRAKTUES	OE ANKUES	REKOMANDIMET E EKSPERTIT	VENDIMI	NR. VENDIMIT
  635-20-5894-2-2-1	Deratizimi, Dezinfektimi, Dezinfektimi në objektet e Komunës së Pejës	€67,000.00	Komuna Pejë	Besim A Zejnullahu B.I	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	157/21
  214-20-7360-1-1-1	Furnizimi dhe implementimi me Licenca të Microsoft-it për nevoja të Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Edukimit	€12,000,000.00	Ministria e Punëve të Brendshme	Cactus SH.A	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	55/21
 701-20-2289-1-1-1	Furnizim me material medicinal jashtë Listës Esenciale për Klinikën e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive	€262,052.50	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Liri-Med SH.P.K.	Aprovohet pjesërisht ankesa / Vërtetohet vendimi i AK	Aprovohet pjesërisht ankesa / Vërtetohet vendimi i AK	182/21
  616-19-9686-5-1-1	Tregu i ri i qytetit	€5,524,160.12	Komuna Prishtinë	Pevlaku SH.P.K.	Refuzohet ankesa	Aprovohet pjesërisht ankesa / Vërtetohet vendimi i AK	106/21

🏠 Për ne

🔍 Si të përdoret?

VENDIMET PËR ANKESAT E OE

VENDIMET PËR LISTË TË ZEZË

VENDIMET PËR GJOBA

VENDIMET PËR HEQJE PEZULLIMI

EN

SI

  612-20-6436-5-5-8	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informatike	€240,000.00	Komuna Rustine Kosovë	Botek SH.P.K.	Aprovohet pjesërisht ankesa	pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	25/21
 613-20-6092-1-2-1	Furnizimi me shporta për mbeturina materiali plastikë, me vëllim 120litra	€40,000.00	Komuna Lipjan	Seykos SH.P.K.	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	1011/20
 632-20-5688-1-1-1	Furnizim me material të shtypur	€152,000.00	Komuna Gjakovë	NTG Blendi	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	1057/20
 VU644-20-5520-1-2-1	Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve dekorativ	€10,000,000.00	Komuna Vushtrisë	Lulishtja Buqaj	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	1049/20
 72701-20-3652-1-2-1	Furnizim me pajisje mjekësore (Auto Refractometer)	€25,000.00	Instituti i Mjekësisë së Punës së Kosovës	Almakos Group shpk	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	810/20
  72701-20-3652-1-2-1	Furnizim me pajisje mjekësore (Auto Refractometer)	€25,000.00	Instituti i Mjekësisë së Punës së Kosovës	Pro Medical SH.P.K.	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	813/20
  657-20-5829-5-1-1	Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaçanik- Faza e II-të	€2,100,000.00	Komuna Viti	NPSH Bageri	Ankesa e palejuar	Aprovohet pjesërisht ankesa / Përmirësim i dosjes	793/20
  657-20-5829-5-1-1	Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaçanik- Faza e II-të	€2,100,000.00	Komuna Viti	Rahovica Commerce shpk	Ankesa e palejuar	Aprovohet pjesërisht ankesa / Përmirësim i dosjes	807/20
  632-19-7809-2-1-1	Ri-shpallje-Mirëmbajtja e autorrrugëve Pjesa e I-rë Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane	€240,000.00	Komuna Gjakovë	D&T Group	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	645/20
  217-20-3242-5-2-1	Ndërtimi i pikës së karburantit në kazermen e FSK-Istog	€200,000.00	Ministria e Mbrojtjes	D&T Group	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	588/20

Nr. i protokolli

Emri i rastit:

Vlera e kontratës

Autoriteti Kontraktues

OE Ankues

Rekomandimet e ekspertit

Vendimi

Nr. Vendimit

Shfaqur 1 deri 15 prej 75 të dhënave (prej total 6,172 të të dhënave)

Faqja paraprake

1

2

3

4

5

Faqja tjetër

7

Por gjithashtu Deklarata për Specifikat teknike është në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit